



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
JURIA

Nr. 150 prot.

Tiranë, më 10 mars 2017

Vendim

Nr. 5 datë 10 mars 2017

*Për shpalljen e të nominuarve të Çmimeve Shkencore Kombëtare Vjetore (2016),
që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë*


Juria e çmimeve shkencore kombëtare që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), e krijuar me Urdhrin nr. 4 datë 20.01.2017, *Për ngritjen dhe përbërjen e jurisë së çmimeve shkencore kombëtare vjetore për vitin 2016*, të Kryetarit të ASHSH akademik Muzafer Korkuti; në përbushje të përgjegjësive të veta dhe referuar:

- Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, neni 4, pika dh;
- Nenit 14 të *Rregullores për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë*, për mënyrën e organizimit të konkurseve, për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre, miratuar me Urdhrin nr. 11, datë 6.10.2016;
- Vendimit nr. 5, datë 10.10.2016, *Për shpalljen e organizimit të çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2016*;
- Si dhe dokumentit *Thirrje për pjesëmarrje* në edicionin e parë të çmimeve shkencore kombëtare të ASHSH për vitin 2016:

Konstatoi me kënaqësi se:

1. Konkursi i shpallur nga ASHSH ka zgjuar një interes të shumanshëm brenda vendit dhe në gjithë hapësirën historike shqiptare; në një shumicë qendrash të studimit të identitetit dhe të botës shqiptare nga të gjitha kontinentet: në Europë, në Azi, në SHBA e në Australi; në vendet fqinje e në vende të largëta, si Britania e Madhe, Kina, Australia, Bullgaria etj. Në konkurs u paraqitën 49 punime (vepra) të përgatitura nga mbi 50 autorë.

2. Në këtë konkurs janë paraqitur tre breza dijetarësh: shkencëtarët e karrierës, studiuesit me arritje të dallueshme në kërkim dhe dije; si dhe studiuesit e rinj në formim e sipër, me të ardhme akademike dhe universitare.



3. Arritjet e shkencave shoqërore-albanologjike dhe ato teknike-natyrore të dëshmuara nga prurjet e këtij konkursi janë cilësore. ASHSH e konsideron detyrë të saj të përveçojë arritjet më të rëndësishme, duke konsideruar se përmes kësaj ajo njëherësh identifikon edhe shkallën e lartë të kërkesave të saj.

Njëherësh, pas disa mbledhjesh të saj dhe pas disa diskutimesh në fryshtat debati të lirë, ku janë bërë të njobura ekspertizat e specialistëve të brendshëm e të ftuar, në një proces të gjatë diskutimi të fryshtshëm, Juria e ngritur për çmimet e konkursit vjetor 2016, me votim të fshehtë, në mbledhjen e datës 10 mars 1017,

Vendosi:

1. Të shpallë të nominuar për *Çmimin shkencor kombëtar vjetor “Çabej”*, që jepet për studimin më të mirë në fushën e shkencave shoqërore-albanologjike, këto vepra:

Nr.	Titulli i veprës	Autori
1.	Fjalorë shqip-gërgjisht gërgjisht-shqip	Dhori Qirjazi
2.	Zhvillime të mjeteve gramatikore të shqipes	Ethem Likaj
3.	Mitet e historiografisë arbëreshe	Matteo Mandalà
4.	Arbërit e Jonit	Pëllumb Xhufi

2. Të shpallë të nominuar për *Çmimin shkencor kombëtar vjetor “Radovicka”*, që jepet për studimin më të mirë në fushën e shkencave natyrore-teknike, këto vepra:

Nr.	Titulli i veprës	Autori
1.	Ujërat termale dhe minerale të Shqipërisë	Alfred Frashëri, Romeo Eftimi
2.	Bazat dhe metoda klinike e trajtimit të dhimbjes fantomë.	Apostol Vaso
3.	Polimorfizmi gjenetik i sistemit HLA në popullatën shqiptare dhe roli i markuesve imunologjikë dhe imunëgjenetikë në realizimin e transplantove dhe diagnozën e sëmundjeve autoimune.	Genc Sulçebi
4.	Pasuritë ujore të Shqipërisë	Niko Pano



3. Të shpallë të nominuar për Çmimin shkencor kombëtar vjetor për kërkuesin e ri më të suksesshëm në fushën e shkencave shoqërore-albanologjike, këto vepra:

Nr.	Titulli i veprës	Autori
1.	Katërungjillëshi i dekoruar i Korçës	Andi Rëmbeci, Sokol Çunga
2.	Arbërorët (ndërmjet kishës perëndimore dhe asaj lindore gjatë shek.XI-XV)	Gjon Berisha
3.	Antropologji e Kanunit	Nebi Bardhoshi

4. Të shpallë të nominuar për Çmimin shkencor kombëtar vjetor për kërkuesin e ri më të suksesshëm në fushën e shkencave natyrore-teknike këto vepra:

Nr.	Titulli i veprës	Autori
1.	Integrating antimicrobial therapy with host immunity to fight drug-resistant Infections: Classical vs Adaptive treatment.	Erida Gjini
2.	Molecular Evolution of Pyroglutamylated RFamide peptide and Orphan G Protein Coupled Receptor.	Rigers Bakiu

5. Ngarkohen sekretaria e Jurisë, specialisti i IT-së dhe specialisti i komunikimeve shkencore për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të ASHSH dhe në media pas shpalljes publike zyrtare të tyre në një konferencë për shtyp, që do të organizojë Juria në datën e caktuar prej saj.

Në përfundim, Juria e çmimeve shkencore kombëtare që akordohen nga ASHSH falënderon të gjithë pjesëmarrësit që iu përgjigjën pozitivisht thirrjes së saj, çmon punën e tyre kërkimore-shkencore dhe shpreh dëshirën e saj për të mirëpritur sërisht në edicionin e vitit të ardhshëm konkurrentë të denjë nga të gjitha fushat ku ajo ka veprimtari shkencore të parashikuar prej akteve ligjore e nënligjore.

Juria do të shprehet me vendim të veçantë për fituesit e çmimeve.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

